




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2025, merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 128/26, të datës 24.03.2026.P-P-71510057-09038-3 ZK-Rahovec
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
  - 2.1. **Albnor Mullabazi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
  - 2.2. **Afrim Oruqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
  - 2.3. **Mentor Durguti**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - AAK
  - 2.4. **Behlul Krasniqi**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - PDK
  - 2.5. **NazmiBellaqa**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 (njëzet e pesë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit, i cili përfshin: emrin, përshkrimin, sipërfaqen, destinimin dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim; afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës; veprimtarinë që mund të ushtrohet; afatin e fundit për aplikim; vendin ku bëhet pranimi i ofertave për shprehje të interesit, si dhe informacionet shtesë.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores

(QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

430  
01 Nr. ~~128~~26  
Datë: 24.03.2026

